

INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

NJOFTIMI PËR MODIFIKIMIN E MARRËVESHJES KUADËR/KONTRATËS GJATË ZBATIMIT

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor

Emri INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK
Adresa Rruga “Aleksandër Moisiu”, nr. 80, Tiranë
Tel/Faks +35542374756 / +35542370058
E-mail info@ishp.gov.al
Ueb-faqe www.ishp.gov.al

2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

Emri Manjola Bunguri
E-mail Manjola.Bunguri@ishp.gov.al _

3. Lloji i procedurës së prokurimit: E hapur e thjeshtuar- prokurim me mjete elektronike

4. Lloji i kontratës /Marreveshjes kuader: “Sherbime”

5. Numri i referencës për procedurën / Lotin: REF-79276-09-07-2023

6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër : “Supervizimi për ndërtimin e godinës së re të laboratorëve në ISHP”

7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): 71247000-1 - Mbikëqyrja e punës së ndërtimit

8. Fondi limit: 3,612,231.05 (tre milion e gjashtëqind e dymbëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë e një.05) Lekë pa TVSH.

9. Situata sipas parashikimeve të nenit 127 të LPP dhe argumentet përkatëse për ta përdorur atë: Kontrata është modifikuar bazuar në nenin 127, pika 1, germa “c”, në të cilën citohet se: “kur modifikimi është bërë i nevojshëm për shkak të rrethanave të paparashikueshme nga autoriteti kontraktor dhe që nuk ndryshojnë në thelb natyrën e kontratës publike apo të marrëveshjes kuadër”, bazuar në relacionin me nr. 792/5 Prot. datë 24.07.2025 të hartuar nga specialisti i fushës i kontraktuar me anë të kontratës për asistencë teknike me nr. 792/4 prot., datë 24.07.2025.

10. Përshkrimi i modifikimit të kontratës/Marrëveshjes Kuadër, përfshirë natyrën dhe sasinë ose vlerën e punimeve

- Është lidhur kontrata e supervizimit me nr. 825/5 prot., datë 30.10.2023 me objekt: “Supervizimin për Ndërtimin e godinës së re të laboratorëve të ISHP-së”.

- Më datë 17.07.2025, nga shoqëria “AGRI CONSTRUCTION” sh.p.k., është paraqitur shkresa nr. 129 prot., datë 15.07.2025, e protokolluar në ISHP me nr. 792 prot.

- Po më datë 17.07.2025, nga mbikëqyrësi i punimeve, shoqëria “ARKIMADE” sh.p.k., është paraqitur shkresa nr. 429 prot., datë 16.07.2025, e protokolluar në ISHP me nr. 792/1 prot.

- Në relacionin me nr. 792/5 prot., datë 24.07.2025, të hartuar nga specialisti i fushës, i kontraktuar në bazë të kontratës për asistencë teknike nr. 792/4 prot., datë 24.07.2025, është argumentuar nevoja për shtyrje të afatit të përfundimit të punimeve për objektin “Ndërtimi i godinës së re të laboratorëve në ISHP” deri më datë 26.09.2025, për shkak të kohës së nevojshme për testimin e të gjitha rrjeteve dhe pajisjeve të montuara në objekt.

- Duke qenë se firma zbatuese ka nevojë për furnizim me energji elektrike në objekt, në mënyrë që të kontrollojë dhe vërë në funksion rrjetet teknologjike, si dhe të provojë dhe ngarkojë të gjitha pajisjet e instaluar, është e domosdoshme shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve, sipas kërkesës së bërë nga Mbikëqyrësi i Punimeve.

- Duke qenë se është hartuar amendim nr. 1 i kontratës së sipërmarrjes me nr. 1013 prot. datë 10.10.2023, me objekt: “Ndërtimi i godinës së re të laboratorëve të ISHP-së” dhe është amenduar afati Neni 4.2 pika 3 “Realizimi i kontratës”, ndryshon si më poshtë:

ISHTE:

Afati i ekzekutimit të kësaj kontrate do të jetë 16 (gjashtëmbëdhjetë) muaj, nga data e mbajtjes së procesverbalit të fillimit të punimeve”.

BEHET:

Afati i ekzekutimit të kësaj kontrate do të jetë 18 (tetëmbëdhjetë) muaj, nga data e mbajtjes së procesverbalit të fillimit të punimeve”.

- Duke marrë shkas nga përcaktimet e nenit 681 të Kodit Civil të RSH, ku parashikohet se: Kur interpretohet një kontratë, duhet të sqarohet se cili ka qenë qëllimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve, pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, si dhe duke vlerësuar sjelljen e tyre në tërësi, para e pas përfundimit të kontratës.

- Duke marrë shkas nga përcaktimet Neni 690 të Kodit Civil të RSH, ku parashikohet se: Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të prishet ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj.

PËR SA MË SIPËR, palët bien dakord si më poshtë:

1. Afati për realizimin e shërbimit të supervizimit (mbikqyrjes) së punimeve do të jetë 18 (tetëmbëdhjetë), i njëjtë me afatin e realizimit të punimeve. (nga dita e përcaktuar për fillimin e punimeve).
 2. Shtyrja e afatit të realizimin e shërbimit të supervizimit (mbikqyrjes) së punimeve është bërë në bazë të nenit 22 pika 22.1, Zgjatja e afatit të kontratës së supervizimit me nr. 825/5 prot., datë 30.10.2023
 3. Vlefshmëria e këtij amendamenti shtrihet nga data 26.07.2025 deri më 26.09.2025, në mbështetje të argumenteve të paraqitura nga Mbikëqyrësi dhe të relatuara nga specialisti i fushës, i kontraktuar në bazë të kontratës për asistencë teknike nr. 792/4 prot., datë 24.07.2025, dhe të miratuara nga Investitori.
 4. Për periudhën për të cilën kërkohet shtyrja e afatit të kontratës, kontraktori merr përsipër të sigurojë kontratën, e cila do të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e kërkuar në këtë amendim kontrate.
11. Vlera totale e kontratës së nënshkruar/marrëveshjes kuadër : 3,319,500.00 (tremilion e treqind e nëntëmbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH
12. Vlera e ndryshuar (nëse është rasti): Nuk është aplikuar
13. Kohëzgjatja e kontratës / Marrëveshjes Kuadër : Afati për realizimin e shërbimit të supervizimit (mbikqyrjes) së punimeve do të jetë 16(gjashtëmbëdhjetë) muaj, i njëjtë me afatin e realizimit të punimeve. (nga dita e përcaktuar për fillimin e punimeve).
14. Dhe afati i ri (nëse është rasti): Afati për realizimin e shërbimit të supervizimit (mbikqyrjes) së punimeve do të jetë 18 (tetëmbëdhjetë), i njëjtë me afatin e realizimit të punimeve. (nga dita e përcaktuar për fillimin e punimeve). (nga data 26.07.2025 deri me date 26.09.2025).
14. Emri dhe adresa e operatorit/ëve Ekonomik:
Emri: "ARKIMADE" sh.p.k.
NIPT: L01906030A
Adresa: Tiranë, Rruga Himë Kolli, Ndërtesa nr. 24, Hyrja nr. 9, Apartamenti nr. 14,
Kontaktet: 0682056076
15. Data e nënshkrimit të modifikimit : 24.07.2025
16. Burimi i financimit: Buxheti i shtetit
17. Informacion tjetër që vlerësohet i nevojshëm nga autoriteti/enti kontraktor: _____